

BASHKIA KAVAJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Kavajë

Adresa: Rruga "Josif Budo", Ndërtesa Nr. 10,

Email: kadastra.bashkiakavaje@gmail.com

Tel: 055245555

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja prej 11800 m² e pasurisë nr. 74, lloji pasurisë "pa frut" pasuri e cila është në administrim të Bashkisë Kavajë, regjistruar në ASHK-në Kavajë me indeks harte kadastrale K-34-100-(99-B) ndodhur në Z.K. 1397 Çetë Njësia Administrative Helmës.

3. Qëllimi i dhënies me qira: Pasuria objekt i dhënies me qira do të jepet me qëllim zhvillimin e veprimtarisë bujqësore dhe/ose përdorim blegtoral, sipas objektit të veprimtarisë së subjektit qiramarrës, veprimtari e cila do të gjenerojë të ardhura dhe nxisë punësimin.

4. Afati për dhënien me qira të pasurisë nr. 74, lloji pasurisë "pa frut" në ZK 1397 Çetë, Njësia Administrative Helmas, do të jetë 10 (dhjetë) vjet, nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Vlera dysheme për detyrimin e qirase: 6000 (gjashtë mijë) lekë/ha për një vit kalendarik.

6. Konkurrimi publik për marrjen me qira do të kryhet në ambientet e Bashkisë Kavajë me datë 21.06.2024 në orën 11:00.

7. Vlerësimi i ofertave të konkurentëve do të bëhet me pikët si më poshtë:

Niveli i investimit 40 pikë

Niveli i punësimit 30 pikë

Çmimi i ofruar (lekë/ha në vit) 30 pikë

8. Subjektet konkurrese duhet të përcjellin dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore e cila të përmbajë të dhënat e kërkuarit, pasurinë e cila kërkohet të merret me qira e identifikuar me numrat kadastrale përkatës, qëllimin e marrjes në përdorimit të pronës shtetërore
- planbiznes të hollësishëm për përmirësimin e pronës, i cili duhet të përmbajë siglën dhe vulën e administratorit të shoqërisë, në çdo faqe të tij.
- përshkrimin e projektideve të investimit ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimit si dhe treguesit që do të realizohen
- ofertën për vlerën e detyrimit vjetor të qirasë
- Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - Deklaratë mbi NIPT/NUIS të subjektit kërkuar
 - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore
 - Deklaratë mbi administratorin dhe subjektin juridik ofertues nëse është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin
- në rastet kur subjekti konkurrese zhvillon aktivitet me qira ose enfeiteozë në objekte pronë shtetërore, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht skualifikues.

9. Dokumentacion duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për marrje me qira“, dhe i dorëzohen komisionit të shqyrtimit të ofertave, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

10. Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

11. Data e zhvillimit të konkurrimit: në ambientet e Bashkisë Kavajë, me datë 21.06.2024 në orën 11:00.

12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 21.06.2024 në orën 11:00.